

VENDIM
Nr.424, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS QENDËR BULGAREC TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.163, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Bulgarec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: qendër Bulgarec

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-30	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
58-70	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
85-102	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
1,2,3,31-57	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
103-116	Shërbim funeral	Në pronësi
182,186,187,189-217	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna) dhe shërbime publike	Në pronësi
71-81	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdolloji	Në përdorim
325,326,329,331,333,336, 338,340,341,342,344,345,34	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë	Në përdorim

6,348,349,350	dhe të ushqimit (toka produktive)	
229,253,277,285,295,302,312,315,320,327,328,330,332,334,335,337,339,343,347	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
351-363	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi